

Pakoja informuese në lidhje me kompensimin për personat e ndikuar nga procesi i përvetësimit të tokë për (LP)

Procesi i shpronësimit për tokën e ndikuar nga projekti i (LP) zbatohet nga Ministria e Mjedisit dhe Infrastrukturës në përputhje me Ligjin Nr.03 / L-139 për Shpronësimin e Pronave të Paluajtshme. Seancat dëgjimore publike në lidhje me këtë proces u organizuan nga Ministria në fillim të vitit 2019. Përveç kësaj SOWI Kosova, në bashkëpunim me institucionet e tjera qendrore dhe lokale organizuan një seri aktivitete në terren në komunën e Mitrovicës, fshatit Bajgorë dhe komunën e Vushtrrisë. Gjatë këtyre takimeve, publikut dhe komunitetit iu dha informacion në lidhje me projektin e LP, vlerësimin mjedisor dhe social, ndikimet e projektit dhe masat zbutëse të përshtatura për të minimizuar ndikimet e identifikuara përmes studimeve të bëra më parë.

Më 17 dhjetor 2019, qeveria e Kosovës nxori vendimin përfundimtar Nr.05 / 115 mbi shpronësimin që përfaqëson fazën përfundimtare të përvetësimit të tokës për LP. Në fund të vitit 2019, Ministria e Mjedisit dhe Infrastrukturës dorëzoi pakot individuale të kompensimit të tokës për të gjithë pronarët e tokave të prekur nga projekti i LP. Ministria ka identifikuar të gjithë pronarët e tokave të prekur përmes listave të kadastrave dhe ka shpërndarë pakot e kompensimit përmes postës. Nëse jeni një familje e prekur nga shpronësimi për përvetësimin e tokës për LP dhe nuk keni marrë dokumentet e vlerësimit, atëherë mund të drejtoheni tek Departamenti i Shpronësimit në Ministrinë e Mjedisit dhe Infrastrukturës (ish-ndërtesa Rilindja) në katin e 14-të, dhe të merrni paketën tuaj të vlerësimit. Ju gjithashtu mund të kontaktoni në Departamentin e Shpronësimit përmes numrit të telefonit: 038 200 32023

Për të respektuar praktikat më të mira në projektet e përvetësimit të tokës, dhe në përputhje me standardet e Kërkesave të Performancës të BERZH-it, SOWI Kosova ka prokuruar ekspertë të certifikuar vendorë për të kryer studime të mëtejshme dhe për të siguruar që familjet e prekura nga projekti, të kompensohen në mënyrë të drejtë për humbjen e aseteve dhe aktiviteteve bujqësore, që ata mund të përballen për shkak të aktiviteteve të projektit. Vlerësimi i këtyre aseteve ndodhi gjatë janarit të vitit 2020, pasi ishin njoftuar më parë komunitetet lokale përmes një angazhimi kuptimplotë me drejtuesit e komunitetit lokal. Personat e ndikuar u arritën përmes mjeteve të komunikimit masiv (TV dhe radio lokale), dhe shumë të tjerë u kontaktuan individualisht. Rezultatet e këtyre vlerësimeve përshkruhen në një studim specifik të quajtur Plani për përvetësim të pronave dhe rivendosje të jetesës (LALRP), i cili është përgatitur nga SOWI dhe është aprovuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në Mars 2020. Ky plan shpjegon casjen dhe metodologjinë e përdorur për të siguruar një kompensim të drejtë.

Në këtë zarf do të gjeni informacionet përkatëse në lidhje me të drejtat dhe përfitimet tuaja. Përveç aktit të vlerësimit dhe vlerës së kompensimit të tokës të shpërndarë nga Ministria, SOWI po ofron kompensime shtesë për humbjet e përmendura më lart, siç përshkruhen më detajisht në LALRP. Dokumentet e bashkangjitura japin informacione për kompensimin tuaj, si dhe informacione të tjera në lidhje me përfitimet e prodhimit të energjisë. Ky zarf gjithashtu përmban një përshkrim të shkurtër të projektit dhe një përmbledhje të LALRP. Dokumentet e plota me informacione të mëtejshme mund të gjenden në faqen e internetit të SOWI Kosova: www.sowikosovo.com

Inkurajoheni të veproni menjëherë, pas marrjes së kësaj pakete të kompensimi, në mënyrë që të përfundoni marrëveshjet e përvetësimit të tokës dhe të merrni përfitimet tuaja.

Nënshkrimi i marrëveshjes kërkon që ju të paraqisni dokumentet e pronësisë së tokës, autorizimin nga pronari i tokës nëse është e nevojshme, kopjen e kartës së identitetit, konfirmimin e llogarisë bankare, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara në varësi të rastit specifik. Ju lutemi na telefononi në numrin e shkruar më poshtë për të marrë ndihmë rreth dokumenteve të nevojshme dhe plotësimin e kërkesave për kompletimin e aplikacionit për kompensim.

Ndërtimi i themeleve dhe montimi i turbinave të erës do të zgjasë rreth 70 javë / 18 muaj dhe lidhja e tyre me rrjetin do të zgjasë rreth 2 javë.

Për më tepër, kohëzgjatja e aktiviteteve për instalimin e LP dhe nënstacionit vlerësohet në 14 muaj, nga Marsi 2020 deri në Prill 2021.

Nëse keni ndonjë pyetje ose koment, mund t'i drejtoheni stafit të projektit të SOWI-t, në +383 49 955 533, email në info@sowikosovo.com, ose duke vizituar zyrën e SOWI-t personalisht në adresën më poshtë.

Rr. Perandori Justinian 1/6

10000 Prishtinë, Kosovë

www.sowikosovo.com